



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

**BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 36, datë 30.03.2017**

**PËR**

**MIRATIMIN E SHOQËRISË AUDITUESE “LIRENG AUDITING” SH.P.K., PËR  
AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN 2016, TË BYROSË  
SHQIPTARE TË SIGURIMIT**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 5, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 42, pika 9, të Ligjit nr. 10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, të nenit 123 dhe 124, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të Rregullores nr. 37, datë 28.05.2015 “Për përcaktimin e kriterëve dhe kërkesave për përzgjedhjen e shoqërisë audituese për shoqërinë e sigurimit”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes Financiare, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e shoqërisë audituese “Lireng Auditing” sh.p.k., për auditimin e pasqyrave financiare për vitin 2016, të Byrosë Shqiptare të Sigurimit.
2. Ngarkohet Drejtorja e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Pajtim MELANI**

**NËNDREJTOR EKZEKUTIV**  
**Mimoza KAÇI**